

“LEKSIKON I AUTORËVE SHQIPTARË NË ZVICËR”

të autorëve Prof. Besnik CAMAJ dhe Shefqet DIBRANI

Leksikoni i krijuesve shqiptarë që jetuan apo jetojnë në Zvicër, është një përpjekje për t'i sjellë letërsisë shqipe një vepër me të dhëna për shkrimtarët shqiptarë që ndërtuan individualitetin krijues në këtë vend. Kështu plotësohet një zbrazëti e shënimeve biografike dhe bibliografike, padyshim e para e këtij lloji për autorët shqiptarë në Zvicër. Andaj, edhe përpjekjet për hartimin e tij janë sfiduese dhe të mundimshme. Por për të materializuar idenë, ne kemi marrë për shqyrtim një numër të caktuar veprash të kësaj natyre, duke u përqendruar kryesisht tek vepra e Hasan Hasanit “LEKSIKONI I SHKRIMTARËVE SHQIPTARË 1501 – 2001”, që ishte si një tabelë rrëfimi për të konceptuar punën tonë. Po ashtu, kemi marrë edhe shënime të caktuara nga Enciklopedia e Lirë “Wikipedia”, nga rrjete sociale të internetit, si dhe nga disa libra të cilët kanë shënime të kësaj natyre. Sa do që tendenca jonë ishte këmbëngulëse për regjistrimin e gjithë autorëve shqiptarë që jetuan ose jetojnë në Zvicër, megjithatë, ne nuk kemi arritur ta shterojmë këtë përpjekje.

Në leksikon janë përfshirë pa paragjykitime, të gjithë autorët shqiptarë që kanë publikuar në shqip gjatë qëndrimit të tyre në Zvicër. Fillimisht, kemi menduar të ndalemi vetëm tek të dhënat biografike dhe bibliografike, por me insistimin e bashkautorit, profesor Besnik Camaj, vendosëm që çdo autori t'i bashkëngjisim edhe diçka nga krijimtaria e tyre (*prozë, poezi, apo ndonjë fotografi të ndonjë punimi artistik*). Radhitja e autorëve është sipas alfabetit.

Ky Leksikon përfshin të gjithë autorët për të cilët ne kemi arritur të gjejmë shënime. Të vetëdijshëm për rëndësinë dhe saktësinë e të dhënave, janë shfrytëzuar rrjetet sociale. Me pjesën dërmuese të krijuesve që jetojnë në Zvicër, kemi komunikuar drejtpërdrejt në mënyrë që shënimet e tyre të dalin sa më të plota dhe sa më të sakta. Por jo gjithmonë synimet mund të realizohen sipas planit dhe dinamikës, pasi një pjesë e konsideruar e autorëve kanë qenë në gjendje të bisedojnë me orë të tëra ose të dërgojnë me dhjetëra shkresa duke e hiperbolizuar punën e tyre pa qenë në gjendje të plotësojnë një shënim të thjeshtë, i cili do të na lehtësonte punën tonë në përpilimin e kësaj materieje. Ne si autorë ishim përcaktuar që ta përpilonim këtë vepër mbi bazën e kriterit “*autorët duhet ta kenë së paku një vepër të botuar dhe atë në kohën kur kanë jetuar apo jetojnë në Zvicër*”.

Me vetëdije i jemi shmangur vlerësimin letrar e artistik pasi ne nuk kishim qëllime përjashtuese. Ne kemi bërë disa herë ftesa përmes shumë mediave elektronike dhe sociale, sepse nuk kishin qëllime përjashtuese, por shprehim edhe keqardhje nëse në mungesë të informacioneve mbetet ndonjë autor apo autore jashtë këtij projekti.

Duke i mbetur besnik synimit të mirë, në fund kemi shtuar edhe rubrikën “Shtojcë”, në të cilën kemi përmendur një duzinë emrash e autorësh, të cilët me prezencën e tyre në Zvicër, qoftë me ndonjë promovim libri, ndonjë seminar apo konferencë, ishin pjesë e jetës kulturore shqiptare në Zvicër. Në këtë “Shtojcë” ne jemi të vetëdijshëm se nuk janë përmendur të gjithë autorët, por ne bëjmë atë që mundëm dhe atë që ditëm, duke shpresuar se ndonjë autor tjetër do të arrijë në mënyrë më të përmbledhur për ta pasqyruar këtë realitet edhe në këtë plan.

Zvicra, përveç historisë së vet të bujshme, ka qenë një vend tërheqës edhe për shkrimtarët dhe artistët shqiptarë. Jo vetëm pas Luftës së Dytë Botërore, por edhe shumë më herët (atëherë kur ndodhnin lëvizje të mëdha shoqërore e politike në vendin tonë), në Zvicër kanë jetuar me vite të tëra personalitete të njohura shqiptare.